



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

KUADRI I RI I INSPEKTIMIT NË SHQIPËRI

Një udhëzues ligjor dhe rregullator për bizneset

DHJETOR 2025

KUADRI I RI I INSPEKTIMIT NË SHQIPËRI

Një udhëzues ligjor dhe rregullator për bizneset

Kjo përmbledhje përmban informacion të përgjithshëm të marrë nga ligje, akte nën-ligjore apo dokumenta të tjera pjesë e domain-it publik. Informacioni i përfshirë në këtë Përmbledhje nuk është shtues dhe nuk zëvendëson asistencën apo këshillimin profesional që mund t'ju duhet ju apo kompanisë tuaj për të marrë vendime, si edhe nuk duhet të përdoret si bazë për ndonjë vendim ose veprim që mund të ndikojnë financat apo biznesin tuaj. Përpara marrjes së ndonjë vendimi që lidhet me sa më sipër, ju lutem konsultoni legjislacionin përkatës të zbatueshëm në faqet zyrtare, të vendosura me hyperlink në brendësi të Përmbledhjes. Sekretariati i Këshillit të Investimeve nuk është përgjegjës mbi saktësinë e këtij informacioni dhe as mbi ndonjë vendim të marrë nga ju mbi bazën e informacionit të dhënë në këtë Përmbledhje.

KËSHILLI I INVESTIMEVE është një platformë e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), me synim intensifikimin e dialogut mes qeverisë dhe sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit dhe promovimin e mirë qeverisjes. Platforma mbështetet nga Sekretariati i përbërë nga një grup i pavarur profesionistësh të zgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërdrejtë me komunitetin e biznesit. Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).

PËRMBAJTJA

HYRJE

01 PJESA I. INSPEKTIMI DHE RREGULLAT KRYESORE

OBJEKTIVAT	9
CILAT FUSHA NUK MBULOHEN NGA KUADRI I RI LIGJOR DHE RREGULLATOR?.....	9
PARIMET E INSPEKTIMIT	10
LLOJET E INSPEKTIMIT	11
DOKUMENTET DHE PROCEDURA E INSPEKTIMIT.....	11
TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË INSPEKTIMIT.....	14
DETYRAT E SUBJEKTIT TË INSPEKTIMIT.....	15
TË DREJTAT E INSPEKTORËVE	15
MARRJA E MOSTRAVE	16
MARRJA E KOPJEVE DHE SEKUESTRIMI I DOKUMENTEVE	16
ANKIMI.....	17

02 PJESA II. INSTITUCIONET DHE STRUKTURAT E INSPEKTIMIT

BORDI I INSPEKTIMEVE.....	20
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM.....	20
KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKIMIT PRANË INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM.....	21
INSPEKTORATET QENDORE.....	21
INSPEKTORATET VENDORE.....	22
KOMISIONI I REKRUTIMIT DHE ECURISË NË KARRIERË	23
KOMISIONI DISIPLINOR	23

HYRJE

Këshilli i Investimeve (KI) që në vitin 2016 në [Mbledhjen nr. 4](#), evidentoi se pas vendimeve të administratës tatimore dhe asaj doganore, vendimet e inspektoriateve shtetërore krijojnë impaktin më të madh financiar dhe barrën administrative më të lartë për bizneset. Nga analiza u evidentua se edhe procesi i ankimit administrativ i vendimeve të tyre ishte pothuajse formal, pasi strukturat e apelimit në pjesën dërrmuese të rasteve linin në fuqi sanksionet fillestare. Kjo i detyronte bizneset t'i drejtoheshin gjykatave administrative në procese gjyqësore që krijojnë një barrë akoma dhe më të madhe si në aspektin e kohëzgjatjes së gjykimit (2-5 vjet) ashtu edhe në aspektin financiar (kostot e procedurave).

Në vijim, në fillim të vitit 2019, në [Mbledhjen nr. 15](#), KI evidentoi se problematikat me inspektoriatet ishin të natyrës sistemike. Perceptimet dhe komentet e komunitetit të biznesit konfirmuan sërish se aspektet që lidheshin me procedurat e inspektimeve dhe numri i lartë tyre ndikonin thelbësisht mbi klimën e biznesit. [Nota Teknike](#) nënvizoi se një reformë sistemike e inspektimeve është me rëndësi të jashtëzakonshme, pasi përfshin shumë procese dhe institucione që ndërveprojnë me bizneset dhe pavarësisht modelit që ndjek, ajo duhet të përqendrohet në tre aspekte: (i) reformimin ligjor, (ii) strukturën institucionale (iii) investime në sistemet e informacionit. Nota teknike prezantoi në mënyrë analitike një kuadër gjetjesh dhe rekomandimesh që mund t'i adresonin këto çështje në mënyrë sistemike.

Sistemi i inspektimeve në Shqipëri ka qenë për një kohë të gjatë i fragmentuar (shumë institucione me role të mbivendosura), burokratik dhe joefikas, shpesh perceptohet si një hapësirë për abuzim ose presion mbi biznesin dhe i orientuar më shumë drejt ndëshkimit sesa parandalimit. Kjo ka krijuar barrë administrative dhe kosto të panevojshme për biznesin, ka ulur besimin tek institucionet dhe ka dëmtuar klimën e investimeve. Mbi këto premisa të pranura gjerësisht, filloi reforma e inspektimeve.

Ligji nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" u miratua në vitin 2024 dhe shfuqizoi ligjin e mëparshëm nr. 1044, datë 16.06.2011. Ligji i ri u prezantua për komunitetin e biznesit si pjesë e reformës së

derregullimit më 14 maj 2024,¹ dhe më pas iu nënshtrua procesit zyrtar të publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftim dhe Konsultim Publik nga Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Ai përbën bazën kryesore ligjore mbi të cilën organizohen inspektimet dhe inspektoratet në nivel qendror dhe lokal. Ligji përcakton funksionet, rregullat dhe procedurat që zbatohen gjatë ushtrimit të veprimtarive inspektuese, si dhe punësimin, rekrutimin, trajnimet dhe zhvillimin e karrierës së inspektorëve.

Më konkretisht, ligji ka për qëllim: (i) Unifikimin e sistemit të inspektimit nën standarde të përbashkëta (ligjore, metodologjike dhe teknologjike); (ii) Reduktimin e numrit të kontrolleve fizike, duke kaluar drejt mbikëqyrjes së bazuar në rrezik; (iii) Digjitalizimin e proceseve përmes një platforme qendrore të inspektimit (p.sh., e-Inspektimi); (iv) Rritjen e transparencës, në mënyrë që bizneset të njihen me të drejtat, detyrimet dhe procedurat standarde; (v) Forcimin e orientimit drejt parandalimit, jo vetëm ndëshkimit; (vi) Uljen e kontaktit fizik midis inspektorëve dhe bizneseve, për të reduktuar mundësinë e abuzimit. Në vijim të ligjit, me [VKM nr. 408, datë 16.7.2025](#) janë parashikuar 14 institucione që duhet t'i nënshtrohen procesit të riorganizimit.

Për më tepër, ligji 99/2024 sjell disa risi: (i) fusha e tij e zbatimit përfshin gjithashtu rregullat dhe procedurat që administrata tatimore përdor gjatë ushtrimit të veprimtarive inspektuese në fushën e tatimeve për verifikime në vend; (ii) krijohet Bordi i Inspektimit si një strukturë e përhershme, koordinuese dhe udhëzuese për aktivitetet inspektuese, në bashkëpunim me Inspektorin e Përgjithshëm; (iii) inspektimet duhet të kryhen nga një trup kolegjal inspektorësh; (iv) riorganizimi dhe reduktimi i numrit të inspektorateve.

Nga analiza jonë e ligjit, ai adreson disa nga problemet kryesore që kanë dalë në vitet e fundit, siç janë mungesa e koordinimit midis inspektorateve, inspektimet e mbivendosura dhe mungesa e një procesi të qartë dhe të drejtë ankimesh. Disa [rekomandime të KI](#) janë reflektuar plotësisht ose pjesërisht, si qasja strategjike ndaj reformës, përpjekja për unifikimin e procedurave dhe krijimi i një komisioni apelimi si trup kolegjal i centralizuar që siguron më shumë garanci për vendime administrative të drejta, të unifikuara dhe reduktim të korrupsionit.

Megjithatë, efektiviteti i kuadrit të ri ligjor mund të vlerësohet vetëm kur zbatimi i tij të përkthehet në praktikë të qëndrueshme, duke siguruar

¹ <https://www.kryeministria.al/en/newsroom/reforma-e-inspektimeve-per-nje-sistem-te-bazuar-ne-bashkepunim-transparence-vetedeklarim-jo-ne-penalizime-por-ne-garantimin-e-konkurrences-se-lire/>

që institucionet të zbatojnë dispozitat në mënyrë të unifikuar, që sistemet digjitale të funksionojnë sipas qëllimit dhe që mekanizmat mbrojtës kundër abuzimit dhe arbitraritetit të respektohen. Masa reale e suksesit do të varet nga mënyra se si këto mekanizma funksionojnë në praktikë dhe nëse ato sjellin përmirësime të matshme në transparencë, efikasitet dhe besim në sistemin e inspektimit.

Ligji hyri në fuqi më 13 maj 2025, dhe duhet të plotësohet nga një sërë aktesh nënligjore dhe rregullore që janë ende në proces. Qëllimi i kësaj Përmbledhjeje është të informojë komunitetin e biznesit, institucionet publike dhe palët e tjera të interesuara mbi përmbajtjen, arsyetimin dhe pritshmëritë e reformës së inspektimeve në Shqipëri, bazuar në ligjin nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të miratuara dhe publikuara në Fletoren Zyrtare deri më 25 nëntor 2026.

Reforma e inspektimeve dhe miratimi i ndryshimeve ligjore për të përmirësuar dhe lehtësuar praktikën e inspektimit për bizneset, është dhe një ndër masat konkrete dhe angazhimet e Shqipërisë për grupin e reformave "*Përmirësimi i kuadrit të tërheqjes së investimeve dhe në veçanti kuadri i FDI-ve dhe mjedisi i biznesit nëpërmjet derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve të biznesit*", sipas Agjendës Kombëtare të Reformave 2024-2027². Procesi i integritetit në BE kërkon harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me standardet e BE-së, duke mundësuar një proces inspektimi transparent të bazuar në analizë risku, rregulla të qarta dhe procedura të unifikuara. Këto standarde janë pjesë e kapitujve të *acquis* të BE-së, veçanërisht *Kap. 1 – Lëvizja e Lirë e Mallrave*, *Kap. 20 – Sipërmarrja dhe Politikat Industriale*, *Kap. 28 – Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit*.

Nisur nga ky kontekst, nëpërmjet kësaj Përmbledhjeje synohet të rritet përgatitja dhe pjesëmarrja konstruktive e të gjithë aktorëve në zbatimin dhe monitorimin e reformës së inspektimeve, duke kontribuar në një klimë më të shëndetshme të biznesit dhe investimeve në vend. Qëllimi përfundimtar është të mundësojë një transparencë më të madhe për procesin e integritetit dhe rritjen e ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve mbi paketën e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga integriteti në BE.

² <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/10/621>

PJESA I.

INSPEKTIMI DHE RREGULLAT KRYESORE

1. OBJEKTIVAT

- » Përmirësimi i klimës së biznesit dhe krijimi i kushteve për të realizuar në mënyrë të rregullt aktivitete biznesi;
- » Garantimi i produkteve më të sigurta ushqimore dhe jo-ushqimore, një mjedis më të pastër dhe në zbatim të ligjit, kushte më të sigurta pune, si edhe veprimtari ekonomike në fushën e energjisë dhe transportit në përputhje me detyrimet ligjore;
- » Reduktimi i numrit të inspektimeve në operatorët e biznesit, prej dublikimeve si dhe prej disa fushave të inspektimit, deri në një nivel prej 40%;
- » Ulja e barrës administrative ndaj subjektit, si dhe kostos në kohë/orë inspektimi në subjekt, deri në një nivel prej 40%;
- » Ulja e numrit të ankimimeve të subjekteve që i drejtohen gjykatës për shqyrtimin e procedurave të inspektimit me masë administrative;
- » Implementimi i teknologjisë për të lehtësuar procesin e inspektimit, përfshirë kryerjen dhe raportimin e inspektimeve nëpërmjet sistemit unik të inspektimeve, që ulin kohën dhe kostot për të dyja palët, bizneset dhe administratën;
- » Rregullimi i marrëdhënieve të punësimit dhe ngritja e sistemit të rekrutimit dhe karrierës nëpërmjet testimit, certifikimit dhe rritjes së nivelit profesional sipas fushës së inspektimit.

2. CILAT FUSHA NUK MBULOHEN NGA KUADRI I RI LIGJOR DHE RREGULLATOR?

Nuk janë objekt i këtij ligji:

- » inspektimi i brendshëm me karakter administrativ në sektorin publik;
- » auditimi i brendshëm në sektorin publik dhe inspektimi financiar publik;
- » inspektimi i autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen civile;
- » inspektimi i autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- » kontrolli doganor;
- » inspektimi në industrinë ushtarake;
- » inspektimi i lojërave të fatit.

3. PARIMET E INSPEKTIMIT

PAVARËSIA

Trupa inspektuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e procesit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për inspektimet që kryen.

PROPORCIONALITETI

Gjatë inspektimit, trupa inspektuese kryen vetëm hetimin minimal të nevojshëm për arritjen e qëllimit të inspektimit, vendos dënimin administrativ në mënyrë të përshtatshme sipas ligjit dhe përcakton afatin për korrigjimin e shkeljeve duke marrë parasysh rëndësinë, pasojat dhe rrethanat konkrete të rastit.

PROGRAMIMI I INSPEKTIMEVE

Çdo subjekt inspektohet si rregull mbi bazën e programit të inspektimit. Një subjekt mund të inspektohet jashtë programit vetëm në raste specifike për ngjarje me rrezik, kriza apo denoncime, në kushtet e flagrancës dhe sipas parashikimeve të tjera të detajura në ligj.

DISPOZITA MË E FAVORSHME LIGJORE

Kur ligji është i paqartë ose kontradiktor, trupa inspektuese vepron në mënyrën më pak ndëshkuese për subjektin e inspektimit.

KËSHILLIMI DHE INFORMIMI

Trupa inspektuese këshillon subjektin për parandalimin e shkeljeve dhe e informon qartë për të drejtat, detyrimet dhe pasojat ligjore gjatë procesit të inspektimit.

INFORMIMI I PUBLIKUT DHE MBROJTJA E KONFIDENCIALITETIT

Inspektoratet informojnë publikun për gjetjet dhe masat e inspektimit vetëm kur është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të personave fizikë e juridikë, duke respektuar kufijtë ligjorë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të dhënave tregtare.

TRANSPARENCA

Inspektoratet qendrore dhe vendore e ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë.

4. LLOJET E INSPEKTIMIT

INSPEKTIM I PROGRAMUAR

Është inspektimi që kryhet në bazë të programit të miratuar të inspektimit për çdo inspektorat qendror apo vendor. Çdo inspektim i programuar autorizohet mbi bazën e programit të inspektimit, i cili hartohet duke u bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut. Programi vjetor i inspektimit hartohet nga inspektoratet qendrore bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut, prioriteteve dhe politikave të ministrisë përgjegjëse.

INSPEKTIM JASHTË PROGRAMI

Është ajo formë inspektimi, që kryhet jashtë programit të miratuar të inspektimit, për çdo inspektorat qendror apo vendor. Inspektimi mund të autorizohet jashtë programit të inspektimit me urdhër të posaçëm të kryeinspektorit qendror apo të kryeinspektorit të drejtorisë rajonale ose vendore vetëm në raste specifike. Numri i inspektimeve të kryera jashtë programit nuk duhet të tejkalojë përqindjen e përcaktuar në rregullat themelore të përgjithshme për programimin e inspektimeve, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. DOKUMENTET DHE PROCEDURA E INSPEKTIMIT

AUTORIZIMI

- » Procedura administrative e inspektimit fillon me lëshimin e autorizimit nëpërmjet sistemit unik elektronik "e-Inspektimi".
- » Inspektimi fillon pa autorizim vetëm kur inspektohet për rastet e parashikuara në ligjet e posaçme e që kryhen në pikat e kalimit kufitar të Republikës së Shqipërisë.

PËRMBAJTJA E AUTORIZIMIT

Autorizimi për inspektim përmban:

- » emërtimin e inspektoratit qendror apo vendor përkatës që lëshon autorizimin;
- » objektin e inspektimit;
- » bazën ligjore;
- » datën dhe vendin e lëshimit;
- » gjenealitetet e inspektorëve të autorizuar për të kryer inspektimin, si dhe kodin unik të identifikimit të kartës së inspektorit;

- » gjenealitetet e personave të tjerë të autorizuar për kryerjen e veprimeve ndihmëse;
- » emrin apo emërtimin, adresën e saktë të subjektit të inspektimit, të dhëna për përcaktimin sa më të qartë të subjektit të inspektimit;
- » të dhëna për përcaktimin e saktë të veprimtarisë konkrete që i nënshtrohet inspektimit në rast se emri, emërtimi dhe adresa nuk janë të njohura;
- » kohëzgjatjen e procesit të inspektimit;
- » vendin apo vendet ku do të kryhet inspektimi;
- » gjenealitetet, pozicionin dhe nënshkrimin e kryeinspektorit që ka lëshuar autorizimin.

KOHËZGJATJA E AUTORIZIMIT

- » Autorizimi është i vlefshëm vetëm për kohëzgjatjen e përcaktuar shprehimisht në përmbajtje të tij.
- » Kohëzgjatja e autorizimit mund të shtyhet vetëm një herë për një periudhë jo më të gjatë se kohëzgjatja fillestare, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm.

NUMRI I INSPEKTORËVE

- » Inspektimi kryhet nga të paktën tre inspektorë, të përcaktuar në autorizimin e inspektimit. Numri i anëtarëve të trupës inspektuese duhet të jetë numër tek.
- » Para fillimit të procedurës së inspektimit, inspektori identifikohet me kartën e inspektorit.

MBËSHTETJA E VEPRIMEVE TË INSPEKTIMIT

- » Trupa inspektuese, për vërtetimin e fakteve dhe të rrethanave të nevojshme për marrjen e një vendimi përfundimtar të inspektimit, mund të kërkojë ndihmë të specializuar nga nëpunës, organe publike apo ekspertë e subjekte private të certifikuar kur trupa inspektuese nuk i ka njohuritë e posaçme ose teknike.

NJOFTIMI I INSPEKTIMIT

- » Inspektimi i bëhet i ditur subjektit nëpërmjet njoftimit paraprak të autorizimit për kryerjen e inspektimit me mjete elektronike (online) ose në formë të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të procedurës së inspektimit.
- » Njoftimi paraprak i inspektimit nuk kryhet në raste specifike si p.sh., kur ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit apo kur mosnjoftimi përcaktohet shprehimisht nga ligji i posaçëm, etj.

VENDI DHE KOHA E INSPEKTIMIT

- » Vendi i inspektimit përcaktohet në autorizim.
- » Vendi i inspektimit është kudo ku kryen veprimtarinë e tij subjekti i inspektimit dhe ku ndodhen faktet që lidhen me respektimin apo mosrespektimin e kërkesave ligjore.

PROCESVERBALI I INSPEKTIMIT

- » Trupa inspektuese, që kryen procedurën e inspektimit, mban procesverbalin e inspektimit.
- » Procesverbali i inspektimit nënshkruhet elektronikisht nga trupa inspektuese dhe subjekti i inspektimit në vendin e inspektimit dhe i njoftohet subjektit brenda 48 (dyzet e tetë) orëve.
- » Në rast se subjekti i inspektimit e ka të pamundur nënshkrimin elektronik të procesverbalit të inspektimit, nënshkrimi i subjektit të inspektimit kryhet nëpërmjet tabletës ose mjeteve të tjera elektronike të përshtatshme për këtë qëllim.
- » Procesverbali i inspektimit përmban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit.
- » Në procesverbalin e inspektimit pasqyrohet këshillimi dhe informimi i subjektit të inspektuar.
- » Pas plotësimit dhe mbylljes së listës së verifikimit, trupa inspektuese plotëson procesverbalin e inspektimit, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin e shqyrtuar.
- » Procesverbali i inspektimit përmban informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit, që të paraqesë me shkrim apo në mënyrë verbale shpjegimet apo kundërshtimet e tij për faktet, rrethanat dhe gjetjet e pasqyruara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por në çdo rast jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, si edhe organin ku paraqiten këto shpjegime e kundërshtime.

VENDIMI PËRFUNDIMTAR DHE AFATI I TIJ

- » Si rregull, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga trupa inspektuese që ka kryer inspektimin brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit të subjektit të inspektimit.

PARALAJMËRIMI SI DËNIM ADMINISTRATIV KRYESOR

- » Paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit.
- » Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim.

- » Paralajmërimi, si masë administrative kryesore, vendoset edhe për rastet kur për shkelje të lehta ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ. Në këtë rast, subjekti i inspektimit dënohet me "paralajmërim".
- » Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim nuk zbatohet në rastet e shkeljeve të rënda për të cilat parashikohet masa e pezullimit të aktivitetit, sipas ligjit të posaçëm.
- » Paralajmërimi shoqërohet me urdhërimin e subjektit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve, që pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit.

SISTEMI ELEKTRONIK "E-INSPEKTIMI"

- » Veprimtaria e inspektimit, që kryhet nga inspektoratet sipas këtij ligji, dokumentohet e administrohet nëpërmjet sistemit elektronik "e-Inspektimi". Baza e të dhënave të sistemit elektronik "e-Inspektimi" administrohet nga Inspektorati i Përgjithshëm.
- » Përdorimi i sistemit elektronik "e-Inspektimi" është i detyrueshëm për të gjitha inspektoratet qendrore dhe vendore nëse nuk kanë në përdorim një sistem elektronik ekzistues në funksion për dokumentimin dhe administrimin e inspektimeve.
- » Inspektoratet qendrore dhe vendore apo institucione të tjera, që kanë në përdorim një sistem elektronik ekzistues në funksion për dokumentimin dhe administrimin e inspektimeve, do të shkëmbejnë, nëpërmjet ndërveprimit, të dhënat e nevojshme për sistemin elektronik "e-Inspektimi".
- » Sistemi elektronik "e-Inspektimi" do të mundësojë qasjen e përdorimit, nëpërmjet moduleve të veçanta, nga organe të tjera publike me funksione inspektimi të përjashtuara nga fusha e veprimit e këtij ligji.
- » Informacioni, që mblidhet nga organet e tjera me funksione inspektimi të përjashtuara nga fusha e veprimit të këtij ligji, mund të përdoret për qëllime statistikore, studimore dhe për hartimin e politikave e të raporteve në fushën e inspektimit.

6. TË DREJTAT E SUBJEKTI TË INSPEKTIMIT

- » të njihet me autorizimin e inspektimit para fillimit të inspektimit;
- » të kërkojë identifikimin e inspektorëve nëpërmjet kartës së inspektorit;
- » të kërkojë kryerjen e inspektimit nëpërmjet sistemit unik elektronik të inspektimit;
- » të jetë i pranishëm dhe të ndjekë vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij të gjitha veprimet e inspektimit;

- » të kërkojë dhe të marrë informacion nga trupa e inspektimit për procedurën e inspektimit e për çdo veprim apo vendim të ndërmarrë gjatë saj;
- » të paraqesë, me shkrim apo verbalisht, mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat apo çështjet me natyrë ligjore, që kanë të bëjnë me inspektimin, të paraqesë propozimet e tij për zgjidhjen e çështjes dhe dokumentet përkatëse, ku i mbështet ato;
- » të kërkojë të njihet dhe t'i njoftohet procesverbali i inspektimit;
- » të paraqesë kundërshtimet e tij për vlerësimin e provave të administruara, për rezultatet e inspektimit dhe për vendimin, që synohet të merret nga trupa inspektuese;
- » t'i kërkojë trupës së inspektimit informacion për mënyrën e korrigjimit të shkeljes së kërkesave ligjore.

7. DETYRAT E SUBJEKTI TË INSPEKTIMIT

- » të caktojë një përfaqësues për të komunikuar me trupën inspektuese gjatë procedurës së inspektimit, në rast se nuk dëshiron të komunikojë drejtpërdrejt me trupën inspektuese;
- » të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të inspektimit dhe marrjen e provave;
- » të ndalojë kryerjen e plotë apo të pjeshme të veprimtarisë kur një gjë e tillë kërkohet me shkrim si element i domosdoshëm për zhvillimin normal të veprimtarisë së inspektimit dhe pasqyrohet në procesverbal nga trupa inspektuese;
- » të sigurojë një vend të përshtatshëm për punën e trupës së inspektimit në rastin kur inspektimi kryhet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë;
- » të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara e të nevojshme për inspektimin, nëse kërkohet nga trupa inspektuese, brenda afateve të përcaktuara prej tij;
- » të lejojë dhe të mundësojë marrjen e dëshmive nga punëmarrësit e tij, nëse një gjë e tillë kërkohet nga trupa inspektuese.

8. TË DREJTAT E INSPEKTORËVE

Trupa inspektuese, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka edhe të drejtat si më poshtë:

- » të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mjete teknologjike të mjedisëve, dokumenteve, instalimeve, proceseve të punës dhe të godinave, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo

sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit;

- » të inspektojë çdo dokument apo regjistrim të nevojshëm për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, përfshirë edhe ato të ruajtura, të krijuara apo të mbajtura në format elektronik, apo çdo teknikë tjetër;
- » të bëjë matjet e nevojshme për të verifikuar respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit;
- » të kryejë verifikime të dokumenteve për identitetin e personave, kur kjo është e nevojshme, sipas objektit të inspektimit;
- » t'i kërkojë subjektit të inspektimit apo punëmarrësve të tij të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar inspektimin;
- » të marrë pa pagesë dhe të përdorë për qëllimet e inspektimit çdo të dhënë për subjektin e inspektimit dhe veprimtarinë e tij nga çdo institucion shtetëror që i disponon ato.
- » të gjitha veprimet procedurale të kryera në subjekt pasqyrohen në procesverbalin e inspektimit.

9. MARRJA E MOSTRAVE

- » Nëse është e nevojshme për qëllimin e inspektimit, trupa inspektuese ka të drejtë të marrë pa pagesë mostra përfaqësuese të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve, sipas parashikimeve në legjislacionin e posaçëm dhe t'ia nënshtrojë ato ekzaminimit apo analizave.
- » Mostrat merren në prani të përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, përveç rasteve kur ai është përjashtuar me vendim të arsyetuar të trupës inspektuese nga të qenit i pranishëm gjatë inspektimit. Përpara marrjes së mostrave, trupa inspektuese i shpjegon përfaqësuesit procedurën e marrjes së tyre.
- » Trupa inspektuese merr mostra në sasinë e nevojshme për kryerjen e ekzaminimit apo të analizave edhe për të siguruar përsëritjen e tij, nëse është e nevojshme.
- » Ekzaminimi dhe analiza e mostrave bëhen nga subjektet e akredituara apo të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

10. MARRJA E KOPJEVE DHE SEKUESTRIMI I DOKUMENTEVE

- » Gjatë procedurës së inspektimit, trupa inspektuese ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me

objektin e inspektimit. Kërkesa bëhet verbalisht dhe pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Çdo kopje dokumenti i marrë në dorëzim nga trupa inspektuese nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit të inspektuar ose nga përfaqësuesit të autorizuar prej tij.

- » Trupa inspektuese ka të drejtë të sekuestrojë dokumente që lidhen me objektin e inspektimit, me qëllim verifikimin e origjinalitetit apo të saktësisë së informacionit. Vendimi i sekuestrimit të dokumenteve pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit dhe përmban përshkrimin e plotë të dokumenteve të sekuestruara.
- » Pikat e mësipërme zbatohen edhe për dokumentet e ruajtura në formë elektronike, regjistrimet elektronike dhe ato audiovizive, si dhe nëpërmjet çdo mjeti tjetër elektronik.

11. ANKIMI

VENDIMI I INSEKTORATEVE QENDRORE

- » Ankimi administrativ i paraqitur nga subjekti i inspektimit kundër vendimit përfundimtar në fushën e inspektimit të inspektorateve qendrore dorëzohet dhe shqyrtohet pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit pranë Inspektoratit të Përgjithshëm në përputhje me parashikimet e [Kodit të Procedurave Administrative](#).

VENDIMI I INSEKTORATEVE VENDORE

- » Çdo ankim administrativ i paraqitur nga subjektet e inspektuara kundër vendimeve përfundimtare në fushën e inspektimit të organeve të vetëqeverisjes vendore dorëzohet dhe shqyrtohet pranë komisionit të shqyrtimit të ankimit pranë Bashkisë përkatëse në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.
- » Komisioni i shqyrtimit të ankimit është një organ kolegjal, që ngrihet pranë Bashkisë për të zhvilluar procedurën e shqyrtimit të ankimeve sa herë që është e nevojshme, në rastet e vendimeve të marra nga organet e vetëqeverisjes vendore.
- » Komisioni i shqyrtimit të ankimit duhet të ketë në përbërje një përfaqësues nga organet e përfaqësimit të biznesit, si dhe mund të ketë një përfaqësues nga Inspektorati i Përgjithshëm.
- » Përbërja dhe numri i anëtarëve të komisionit të shqyrtimit të ankimit përcaktohen nga organi kompetent i njësisë së vetëqeverisjes vendore (Bashkia) në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore dhe me këtë ligj.

PJESA II.

INSTITUCIONET DHE STRUKTURAT E INSPEKTIMIT

1. INSPEKTORIATI I PËRGJITHSHËM (IP)

- » Inspektorati i Përgjithshëm krijohet si një institucion publik qendror buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit dhe financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- » Inspektorati i Përgjithshëm koordinon dhe monitoron veprimtarinë inspektuese, administron sistemin unik elektronik, trajnon e certifikon inspektorët, miraton rregulla, metodologji dhe masa disiplinore, trajton ankesa dhe denoncime, menaxhon bazën qendrore të të dhënave dhe raporton para bordit të inspektimit për zbatimin e politikave dhe standardeve.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E IP NË RAPORT ME INSPEKTORATET QENDRORE:

- » jep mendim këshillimor për programet vjetore dhe miraton programet mujore të inspektimit, të hartuara nga inspektoratet qendrore;
- » bashkërendon dhe mbikëqyr ligjshmërinë e veprimtarive inspektuese të inspektorateve qendrore;
- » mbikëqyr zbatimin e kërkesave ligjore nga inspektorët qendrorë për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procesit të inspektimit;
- » jep mendim brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes për programet buxhetore afatmesme dhe afatgjata, të hartuara nga inspektoratet qendrore;
- » kryen procedurat për ngritjen e komisionit të rekrutimit dhe ngritjes në detyrë të inspektorëve, komisionit disiplinor, si dhe komisionit të ankimit për vendimin përfundimtar.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E IP NË RAPORT ME INSPEKTORATET VENDORE:

- » koordinon, mbikëqyr ligjshmërinë e veprimtarive inspektuese të inspektorateve vendore, shmang mbivendosjet e kompetencave me inspektoratet qendrore, mbikëqyr procedurat e rekrutimit, ankimimit dhe largimit të inspektorëve vendorë nga detyra, me qëllim garantimin e respektimit të standardeve në fushën e inspektimit;
- » mbikëqyr zbatimin e kërkesave ligjore nga inspektorët vendorë për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procesit të inspektimit.

2. BORDI I INSPEKTIMEVE

- » Krijohet si organ bashkërendues dhe përcaktues i politikave dhe standardeve të përgjithshme të inspektimit, të cilat zbatohen gjatë veprimtarisë së inspektimit nga inspektoratet përgjegjëse. Bordi i inspektimeve funksionon si strukturë e përhershme, bashkërenduese dhe orientuese e veprimtarisë së inspektimit, në bashkëpunim me Inspektorin e Përgjithshëm.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E BORDIT TË INSPEKTIMEVE:

- » përcakton standardet dhe politikat e përgjithshme të inspektimit;
- » përcakton dhe miraton treguesit e performancës në fushën e inspektimit;
- » përcakton dhe miraton politikën e komunikimit në fushën e inspektimit;
- » jep mendim në përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore në fushën e inspektimit.

3. INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Inspektori i Përgjithshëm drejton veprimtarinë e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe mbështetet nga një Zëvendësinspektor i Përgjithshëm.

PËRGJEGJËSITË E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

- » mbikëqyr zbatimin e politikave të veprimtarisë inspektuese të inspektorateve qendrore, me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë;
- » bashkërendon drejtimit strategjike dhe objektivat e inspektorateve qendrore dhe vendore;
- » nxjerr urdhra dhe rregullore në zbatim të këtij ligji;
- » miraton me propozim të inspektorateve qendrore, vendore dhe strukturave të tjera inspektuese, formën dhe përmbajtjen e dokumenteve standarde, të procedurave të inspektimit;
- » përgatit raportin vjetor të përgjithshëm të inspektimeve për inspektoratet qendrore dhe vendore dhe ua paraqet Këshillit të Ministrave dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- » miraton çdo kërkesë nga inspektoratet qendrore dhe vendore për zbatimin, ndryshimin apo veprimet në sistemin unik *"e-Inspektimi"*;
- » bashkëvepron me institucionet shtetërore, të cilat administrojnë sisteme *"online"* me të dhënat e nevojshme për kryerjen e veprimtarive inspektuese, të cilat do të ndërveprojnë me sistemin unik *"e-Inspektimi"*;

- » urdhëron inspektoratet qendrore, me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar, për fillimin e një inspektimi, në koordinim me inspektoratet vendore, të një subjekti të caktuar apo për një çështje konkrete, që përfshin më shumë se një subjekt.

Rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm parashikohen në **VKM nr. 330 datë 11.06.2025**.

4. KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKIMIT PRANË INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM

Komisioni i shqyrtimit të ankimit është organ kolegjal, që ngrihet pranë Inspektoratit të Përgjithshëm për të zhvilluar procedurën e shqyrtimit të ankimit sa herë që është nevojshme. Komisioni ka në përbërje këta anëtarë:

- » dy përfaqësues nga Inspektorati i Përgjithshëm;
- » një përfaqësues nga ministria përgjegjëse e inspektoratit qendror, ndaj të cilit është drejtuar ankimi;
- » një përfaqësues nga inspektorati qendror, ndaj të cilit është drejtuar ankimi;
- » një përfaqësues nga organizata joqeveritare me aktivitet në fushën e biznesit apo nga organet e përfaqësimit të biznesit.

Rregullat e hollësishme për funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit parashikohen në **VKM nr. 407 datë 16.07.2025**.

5. INSPEKTORATET QENDRORE

- » Inspektoratet qendrore organizohen dhe funksionojnë në nivel qendror, si institucione publike qendrore në varësi të ministrit përgjegjës për zbatimin e politikave të veprimtarisë së inspektimit të ministrive, sipas fushave përkatëse të inspektimit të përcaktuara me këtë ligj dhe detyrave të tjera të parashikuara në ligjet sektoriale.
- » Inspektorati qendror ushtron juridiksion në të gjithë territorin e Republikës

së Shqipërisë. Kur konsiderohet e nevojshme për shkak të kompleksitetit të punës, inspektorati qendror mund të organizohet edhe si drejtori rajonale, të cilat drejtohen nga kryeinspektori i drejtorisë përkatëse.

- » Kryeinspektori i inspektoratit qendror drejton veprimtarinë e inspektoratit qendror dhe emërohet nga Kryeministri me propozimin e ministrit përgjegjës.

PËRGJEGJËSITË E KRYEINSPEKTORIT

- » organizon dhe koordinon funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së inspektoratit qendror;
- » menaxhon burimet njerëzore;
- » menaxhon burimet financiare;
- » nxjerr aktet administrative;
- » raporton për veprimtarinë inspektuese ministrit përgjegjës dhe Inspektorit të Përgjithshëm.

6. INSPEKTORATET VENDORE

- » Struktura që kryen funksionin e inspektimit të parashikuar me ligj, në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, krijohet me vendim të organit kompetent të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore.
- » Organika dhe fushat e inspektimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore miratohen nga kryetari i bashkisë.
- » Kryeinspektori i inspektoratit vendor emërohet nga kryetari i bashkisë.
- » Kryetari i bashkisë mbështet funksionimin efektiv të inspektoratit vendor, me përfshirje të drejtimit operacional të veprimtarisë së inspektimit.

PËRGJEGJËSITË E KRYETARIT TË BASHKISË NË RAPORT ME INSPEKTORATIN VENDOR

- » përcakton objektivat vjetorë dhe afatmesëm strategjikë të inspektoratit vendor;
- » përcakton treguesit specifikë të efektivitetit e të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit dhe punës së inspektorateve vendore.
- » kërkon raporte, informacione dhe dokumente për veprimtarinë e inspektimit në përgjithësi apo për një çështje konkrete.
- » urdhëron me shkrim dhe në mënyrë të motivuar fillimin e një inspektimi për një subjekt të caktuar inspektimi apo për një çështje konkrete, që përfshin më shumë se një subjekt inspektimi.

- » ka akses në sistemin unik elektronik të inspektimit për marrjen e informacionit për veprimtarinë e inspektimit të inspektoratit vendor, të cilin mbulon.

7. KOMISIONI I REKRUTIMIT DHE ECURISË NË KARRIERË

- » Pranë Inspektoratit të Përgjithshëm ngrihet komisioni i rekrutimit dhe ecurisë në karrierë, i përbërë nga 2 anëtarë, përfaqësues nga Inspektorati i Përgjithshëm dhe 1 anëtar, përfaqësues nga inspektorati qendror, i cili ka shpallur vendin vakant. Komisioni i rekrutimit dhe ecurisë në karrierë, për pozicionin "kryeinspektor i inspektoratit qendror", ka në përbërje 1 anëtar shtesë përfaqësues i ministrit përgjegjës të inspektoratit qendror, i cili ka shpallur vendin vakant.
- » Rregullat e hollësishme për funksionimin e komisionit të rekrutimit dhe ecurisë në karrierë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Afatet për zhvillimin e testimit fillestar dhe intervalet e testimit periodik, rregullat për realizimin e procedurës së testimit fillestar dhe periodik të inspektorit, si dhe kriterete vlerësimit të provimit parashikohen në mënyrë të detajuar në **VKM nr. 409, datë 16.7.2025.**

8. KOMISIONI DISIPLINOR

- » Pranë Inspektoratit të Përgjithshëm ngrihet, rast pas rasti, komisioni disiplinor i përbërë nga 2 anëtarë, përfaqësues nga Inspektorati i Përgjithshëm plus 1 anëtar, përfaqësues nga inspektorati qendror, ku inspektori ka emërimin. Komisioni disiplinor për procedimin disiplinor të kryeinspektorit qendror ka në përbërje 1 anëtar shtesë një përfaqësues i ministrit përgjegjës të inspektoratit qendror, ku kryeinspektori ka emërimin.
- » Rregullat e hollësishme për funksionimin e komisionit disiplinor përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Rregulla të detajuara për funksionimin e Komisionit Disiplinor parashikohen në **VKM nr.406 datë 16.07.2025.**



KUADRI I RI I INSPEKTIMIT NË SHQIPËRI

Një udhëzues ligjor dhe rregullator për bizneset



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Staf

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoreshë e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

[f Albania Investment Council](#) [✉ ALInvestCouncil](#) [in Albania Investment Council](#)



MINISTRIA E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT



European Bank
for Reconstruction and Development



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).